




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.64/2024  
Datë: 7 mars 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 9 paragrafi 2 të Rregullores Nr.08/2017 për Praktikantë në Gjykata dhe Sekretariat të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në takimin 322-të, të mbajtur më 7 mars 2024, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Komisionit për Administrim të Gjykatave, Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel dhe Sekretariatit të KGJK-së, i kërkohet analizë për çështjen e pagesës së praktikantëve në gjykata (duke përfshirë numrin e praktikantëve në gjykata, mundësitë lidhur me buxhetin dhe mbështetjen ligjore).
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 7 mars 2024.

## A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në takimin e datës 7 mars 2024, ka diskutuar lidhur me pagesën e praktikantëve në gjykata, ku adresimi i çështjes së pagesës së tyre ka ardhur si rezultat i krijimit të rrethanave të reja përkatësisht rënies së interesimit për aplikim e cila ndërlidhet me rritjen e kostos financiare të jetesës.

Duke parë rëndësinë dhe kontributin e praktikantëve në gjykata është konsideruar e nevojshme që të ketë një analizë të mirëfilltë, sa i përket mundësive buxhetore për kompensimin e tyre, impaktin financiar si dhe mënyrën e realizimit sa i përket aspektit ligjor. Prandaj me qëllim që KGJK-ja të ketë një pasqyrë të qartë për këtë çështje, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Komisionit për Administrim të Gjykatave;
- Komisionit për Buxhet dhe Financa;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe Arkivit të KGJK-së.